



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.897/22

Gjykata Komerciale - Dhoma e Shkalles se Dytë ne Prishtinë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit “...” sh.p.k me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit me shkrim avokat Fatbardh Makolli nga Prishtina, kundër të paditurës KS “...”, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit me shkrim A.N, me objekt kontesti kompensim i dëmit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike I.EK.nr.231/20 e datës 07/12/2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 13/10/2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit, “...” sh.p.k me seli në Prishtinë, e datës 16.12.2021, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike- I.EK.nr.231/20 i datës 07/12/2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktgjykimin e ankimuar I.EK.nr.231/20 e datës 07/12/2021, ka vendosur si vijon:

REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit “...” sh.p.k me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër të paditurit KS “...”, me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar kompenzimin e dëmit material nga sigurimi kasko, në shumën prej 9,500.00 euro.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor, ankesë ka paraqitur paditësja, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që të aprovohet në tërësi ankesa si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i atakuar të priset dhe që çështja të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

E paditura nuk ka dhënë përgjigje në ankesë edhe pse ankesën e ka pranuar me datën 21.12.2021, cka vërtetohet përmes fletëkthesës që gjendet si provë në shkresat e lëndës.

Gjykata Komerciale si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195, 200 e lidhur me nenin 505.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa është e pa themeltë.

Paditësi “...” sh.p.k me seli në Prishtinë, ka paraqitur padi me datën 05.11.2018, pranë kësaj gjykate për kompensimin e dëmit dhe ka kërkuar nga gjykata që pala e paditur t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej; 9,500.00 euro , me kamatë ligjore prej 12% duke filluar nga data e shkaktimit të rastit të siguruar, e deri në pagesën definitive, njëherit ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore kundër të paditurës KS “...”, me seli në Prishtinë.

Gjykata Themelore në Prishtinë -Departamenti Për Çështje Ekonomike me Aktgjykimin EK.nr.583/18 e datës 18/03/2019, kishte kishte aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamenti Për Çështje Ekonomike paditësi dhe pala e paditur kishin ushtruar ankesë në bazë të së cilës Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktvendimin Ae.nr.138/2019, dt.20.05.2020, ankesën e paditësit e ka aprovuar, ndërsa lëndën e ka kthyer në rigjykim.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, sugjerimeve të Gjykatës së Apelit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, në procedurën e rigjykimit ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, me të cilën e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke arsyetuar se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar sa i përket kërkesës për kompenzim të dëmit dhe atë konform dispozitave të nenit 898 të LMD-së.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë të pathemelta qëndrojnë pretendimet ankimore të palës ankuese për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 parg. 2, pika n) të LPK, ngase aktgjykimi i ankimuar del se nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktgjykimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit po ashtu janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsyeje të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë nuk i ka pranuar pretendimet e ankuesit për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë si dhe për zbatim të gabuar të së

drejtës materiale sepse me provat e administruara gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadia e paditëses duhet refuzuar, nga fakti se duke u bazuar në nenin 8 të LMD-së, në të cilin thuhet se *“pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për mbushjen e të njejtit”*. Me nenin 136 al 1 të LMD-së, është paraparë se *“kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*. Në nenin 918 të këtij ligji parashihet se *“me kontratën për sigurimin detyrohet kontraktuesi i sigurimit që mbi parimet e reciprocitetit dhe solidaritetit të paguaj një shumë të caktuar të shoqërisë së sigurimit (siguruesi), kurse shoqëria detyrohet që, nëse ndodhë ngjarja që paraqet rastin e siguruar, t’i paguajë siguruesit apo ndonjë personi të tretë shpërblimin, përkatësisht shumën e kontraktuar ose të kryejë diçka tjetër”*. Ndërsa në nenin 922 parashihet se *“Kontrata për sigurimin është e lidhur kur kontraktuesit nënshkruajnë policën e sigurimit ose listën e mbulesës”* andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e lartë cekura, edhe pse ndërmjet palëve ndërgjyqëse ka qenë e lidhur kontrata e sigurimit “Kasko” në rastin konkret nuk ka bazë për aprovimin e kërkesëpadiës së paditëses, pasi që rasti konkret nuk ka mbulesë siguruese, për shkak se nuk kemi të bëjmë me vjedhje, por kemi të bëjmë me shpërdorim të besimit nga personi i cili e ka marrë automjetin me qira e që sipas kushteve të përgjithshme të kontratës-policës së sigurimit kasko ky rast nuk dëmshpërblehet, pasi që nuk kemi të bëjmë me vjedhje por me shpërdorim të pasurisë së huaj dhe nuk konsiderohet vjedhje nëse kjo bëhet nga vet i siguruari apo përdoruesi i automjetit, e cila është paraparë shprehimisht në nenin 3.1.5 të kushteve të përgjithshme të sigurimit të mjetit motorik “Kasko” të nxjerrë nga e paditura, do të thotë se dëmi nuk është shkaktuar nga e paditura ashtu siç ka pretenduar paditësi dhe as që ka kontribuar në dëmin e shkaktuar.

Dhoma e shkallës së dytë vlerëson se edhe sikur ky rast të ishte vjedhje nuk ka mundur të kompensohet, pasi që në policën e sigurimit kasko si raste të cilat dëmshpërblehen janë të parapara rastet që ndodhin brenda territorit të vendit tonë, ndërsa që vet paditësja me rastin e dhënies me qira të automjetit të lartcekur përdoruesit, të njëjtit i ka dhënë autorizim që ta përdorë si brenda ashtu dhe jashtë vendit (që bie në kundërshtim me policën e sigurimit kasko).

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimore, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike duke dhënë arsye të mjaftueshme, ndërsa pretendimet e paditëses janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë.

Nga arsyet e cekura Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE NE PRISHTINË

DHOMA E SHKALLES SE DYTË

K.DH.SH.II nr.897/22, me datë 13.10.2022

Gjyqtarja-Kryetare e Kolegjit

Saranda Bogaj-Sheremeti